



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

Nr. Dok. 202101654/2

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i menjëhershëm i kushteve të trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve në Institutin e të Miturve Kavajë.*

Drejtuar: **Z. Ulsi MANJA**  
**Ministër i Drejtësisë**

**TIRANË**

**Z. Admir ABRIJA**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve**

**TIRANË**

**Z. Njazi DELIU**  
**Drejtor i Institutit të të Miturve**

**KAVAJË**

**Të nderuar zotërinj**

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues në vijim Mekanizmi Kombëtar ose MKPT, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në neni 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe neni 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institutin e të Miturve, Kavajë, më datë 09.12.2021, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe z. Hazbi Selita me detyrë nd/komisionarë pranë Mekanizmit Kombëtar. Pjesëmarrës në këtë inspektim ishin dhe 6 (gjashtë) përfaqësues të Zyrës së të Mbrojtësve së të Drejtave të Armenisë, delegacioni armen ishte pjesë e MKPT-së përgjatë kryerjes së vizitave monitoruese pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Institucioneve të Shëndetit Mendor etj.

Objekti kryesor i këtij inspektimi ishte vlerësimi i kushteve të Institutit të Miturve në Kavajë për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e ambienteve rekreative me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave që vuajnë dënimin, trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të miturve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Theksojmë se, vizita në këtë institucion u zhvillua në një frymë jo të mirë bashkëpunimi me Drejtuesin e Institutit të të Miturve në Kavajë.

Gjithashtu grupi inspektues i Mekanizmit Kombëtar përgjatë inspektimit i kushtoi fokus të veçantë dhe masave të marra nga institucioni mbi parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Sipas informacionit dhe nga verifikimi i këtyre masave, rezultoi se zbatohet protokollin shëndetësor për masat anti Covid-19. Në hyrje të institucionit, punonjësi i shërbimit kryente matjen e temperaturës me termometër digjital, si dhe kalohej në urën dezinfektuese, duke i evidentuar në një libër të veçantë për çdo punonjës dhe vizitor.

Personeli i institucionit, zbatonte me korrektesë masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, në ambientet e punës me mbajtjen e maskave, duke ruajtur distancimin fizik dhe social, si dhe në mbajtjen e higjienës personale. Urdhrat, udhëzimet dhe protokollet shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë, ishin të afishuar në hyrje të institucionit, zyrat e administratës, në hyrje të regjimit të brendshëm. Ishin shmangur ose minimizuar grumbullimet e stafit në rreshtime, mbledhje dhe kontaktet me të dënuarit dhe njëkohësisht ishin dhënë porosi të miturve, që mos të krijojnë grumbullime gjatë orareve të veprimtarive të përbashkëta.

Personeli shëndetësor i institucionit për kontrollin e menaxhimin e gjendjes shëndetësore të të miturve , një herë në javë kishte ushtruar kontrole, rezultatet e të cilave ishin evidentuar në libra të veçantë.

Për të miturit të cilët për arsye shëndetësore kishin shkuar në urgjencën e spitalit, klinikë private stomatologjike apo në gjykata pas kthimit në institucion ishin karantinuar 14 ditë (Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve). U informuam se nuk ka patur raste infektimi me virusin covid-19 tek të miturit ashtu edhe tek stafi.

Konkretisht, masat e reja kanë filluar të aplikohen nga data 14 qershor 2021 deri në ditën e inspektimit, për një periudhë e cila do të jetë nën monitorim të vazhdueshëm nga të gjitha struktura shëndetësore dhe ekipi drejtues i DPB-së dhe i burgjeve që konsistojnë konkretisht:

1.Rifillimin e lejimit të takimeve të të dënuarve me familjarët, me një takim në muaj duke respektuar distancën e sigurisë, kontrollin shëndetësor, ku familjari është i detyruar të paraqesë vërtetimin e vaksinimit, ose dokumentin e testit se nuk është i infektuar me Covid, apo teste të tjera serologjike që tregojnë se e kanë kaluar situatën e Covidit. Gjatë takimeve do të respektohen të gjitha rregullat e tjera antikovid në institucione që do të jenë ende në fuqi. Por gjithashtu do të vijojnë të ruhet praktika shumë e mirë e krijuar me komunikimin online me Skype.

2.Rifillimin e dhënies së lejeve të veçanta, në zbatim edhe të udhëzimit nr.4 , datë 22.01.2021 i Ministrisë së Drejtësisë, “Për përcaktimin e procedurave të dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta për të dënuarit”. Kjo vetëm për raste mortore gjithmonë sipas parashikimeve ligjore dhe vlerësimit të rrezikshmërisë nga drejtoritë e policisë vendore. Gjithashtu vlerësojmë se udhëzimi duhet të adresojë ndryshe kategorinë e të miturve, pasi parimet e legjislacionit penal për ta janë të ndryshme.

3.Rifillimin e aktiviteteve të përbashkëta, sociale dhe kulturore në mjediset e burgjeve, e cila do të kryhet duke mbajtur në konsideratë dhe duke respektuar distancën e sigurisë dhe

rregullat e tjera anticovid, me qëllim që t'i shërbejë rehabilitimit dhe riedukimit të të gjithë personave të cilët ndodhen në institucione.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij inspektimi kanë për qëllim të vinin theksin në nevojën për të rritur bashkëpunimin ndër-institucional në adresimin e nevojave të fëmijëve, përmirësimin e shërbimeve sociale ekzistuese, ngritjen e programeve të dedikuara për ri-integrim dhe fuqizim të të rinjve, si dhe kushte më të mira jetese duke plotësuar standardet ligjore të parashikuara në aktet kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

Ky institucion është inspektuar në vijim nga Institucioni i Avokatit të Popullit si në rolin e tij si MKPT është edhe në rolin e tij si mbrojtës i të drejtave të Fëmijëve nëpërmjet SMDF, duke bërë dhe rekomandimet përkatëse.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse

### **Shënime paraprake**

Instituti i të Miturve Kavajë funksionon që prej vitit 2009 si qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkolle për të miturit e moshës 14-18 vjeçare. Kapaciteti i institucionit është 40 persona, institucioni ishte i ndarë në 4 sektorë nga të cilët 3 sektorë shërbejnë për të paraburgosurit dhe një sektor për të dënuarit. Në ditën e inspektimit në këtë institucion ndodheshin 17 të mitur ku nga këta janë 16 të paraburgosur dhe 1 i mitur i dënuar. Në 6- mujin e fundit në institucion janë trajtuar gjithsej 40 të mitur.

Në vlerësim të organigramës së këtij institucioni, nga numri total i personelit prej 79 punonjësish, 47 janë punonjës me uniformë dhe 35 janë punonjës civilë. Stafit i sektorit të çështjeve shoqërore përbëhet nga 6 persona, përkatësisht 1 (një) përgjegjës sektori dhe 5 specialistë (punonjës social dhe psikolog). Stafit i sektorit të çështjeve ligjore në këtë institucion përbëhet nga 2 persona, përkatësisht 1 (një) përgjegjës sektori dhe një kartelist. Ndërkohë, që stafit i sektorit të shërbimit shëndetësor përbëhet nga 7 persona, përkatësisht 1 (një) përgjegjës sektori (mjek, i cili është part-time “de-facto”), 1 (një) specialist (mjek stomatolog), 5 ndihmësmjekë, ku njëri prej tyre është ndihmësmjek/farmacist. Pjesa tjetër e stafit përbëhet nga 16 punonjës, 9 punonjës në sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve, 4 punonjës në sektorin e logjistikës, 1 (një) përgjegjës sektori, 3 kuzhinierë dhe 2 punonjës në sektorin e financës dhe drejtuesi i institucionit.

Nga informacioni i grumbulluar nëpërmjet komunikimit me drejtuesin e institucionit z. Njazi Deliu, stafin e institucionit, këqyrja e dokumentacionit, si dhe nga biseda me të 17 të miturit e privuar nga liria, rezultoi se rekomandimet e dërguara pas inspektimit online të bërë në vitin 2020, kanë gjetur zbatim **pjesërisht**:

### **Ishtin plotësuar rekomandimet:**

- mbi marrjen e masave të menjëhershme nga autoritetet përgjegjëse të sistemit penitenciar, për garantimin e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin dhe të dënuar, për realizimin e takimeve “*vis a vis*” - ballë për ballë të të miturve në konflikt me ligjin me familjarët e

tyre, duke respektuar masat anticovid<sup>1</sup>. Në përgjigje të rekomandimit të institucionit të AP-së, Ministria e Drejtësisë, përmes urdhrit<sup>2</sup> nr.372, datë 11.6.2021, bëri të mundur vizitat e të miturve të privuar nga liria në Institutin e të Miturve Kavajë me familjarët, 4 herë në muaj, duke respektuar protokollet e Covid-19.

-mbi marrjen e masave të nevojshme për shtimin e numrit të aktiviteteve me të miturit e cila ndikon drejtpërdrejt në riedukimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri

### **Ndërkohë që nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar rekomandimet:**

1. në lidhje me punësimin e mjekut me kohë të plotë në Institutin e të Miturve Kavajë.
2. në lidhje me rritjen e sasisë së ushqimit për të miturit, që trajtohen në këtë institucion.

Mekanizmi Kombëtar përgjatë inspektimit në Institutin e të Miturve Kavajë, si dhe nga gjenerimi i informacionit të administruar, sjell në vëmendje, se nisur nga rrethanat dhe nevojat e institucioneve të privimit të lirisë, në disa elementë evidentohen probleme më plotësimin korrekt të standardeve për interesin më të lartë të fëmijës, por edhe në kuptimin e zbatimit e hyrjes së legjislacionit penal në këtë fushë.

### **Trajtimi**

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të miturve, identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie.

Në vijim të inspektimit, nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të miturit, grupi inspektues evidentoi një sërë ankesash të cilat lidheshin përgjithësisht me:

- Trajtimin jo human dhe degradues ndaj të miturve përgjithësisht nëpërmjet presionit psikologjik nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve. Të miturit u shprehën se shpesh ndaj tyre përdoret fjalor fyes dhe aspak etik.
- Prezencën e lagështirës në mjediset e fjetjes, pothuajse në të gjitha dhomat, në korridoret e institucionit, në klasat ku zhvillohej mësim, si dhe në palestër.
- Mungesën e ngrohjes, pasi kaldaja vihej në punë vetëm katër muaj, për katër orë në ditë, nëse temperaturat minimale të mjedisit binin nën +5 gradë celsius, kjo sipas

---

<sup>1</sup> *Rekomandim për garantimin e kontakteve me familjen të të miturit në konflikt me ligjin, qoftë i dënuar apo i paraburgosur.* K5/129/2 prot, dt 16.04.2021.

<sup>2</sup> Urdhri nr.372, datë 11.6.2021, i ministrit të Drejtësisë “Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga covid-19 në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

urdhrit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve<sup>3</sup>. Dhe për më tepër nuk kishte as mënyra të tjera të ngrohjes alternative.

- Cilësinë e ushqimit në këtë institucion si dhe sasia e ushqimit e pamjaftueshme dhe jo e shumëllojshme referuar kuotës të përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.
- Mungesën e tendave në mjediset e jashtme të ajrimit, sipas tyre ditëve me shi ata nuk mund të dilnin nga dhoma dhe për pasojë nuk mund të kryenin ajrimin ditor të përcaktuar.
- Mungesën e një frigoriferi të përbashkët ku të miturit mund të vendosnin ushqimet e sjella nga familjarët, pasi në mungesë të tij shpesh herë ushqimet prisheshin dhe ktheheshin në rrezik për shëndetin e tyre.

Në ambientin e Komisionit të pritjes në rregjimin e brendshëm gjetëm një njësi kompjuterike, e cila ju mundësonte të miturve të kryenin takimet online me familjen me Skype nëpërmjet video-konferencës, me kohëzgjatje prej 1 (një) ore, për çdo javë. Këto masa të reja në përshtatje të protokollit anti-Covid, nga ana e të miturve ishte pritur shume mirë, pasi ju mundësonte të komunikoni më shpesh me familjet, por konstatoam se vetëm një kompjuter, ishte i pamjaftueshëm për të zhvilluar komunikimet për 17 të mitur. Sipas Urdhrit Nr.327, Dt.11.06.2021 të Ministrisë të Drejtësisë udhëzohet: Të garantohet jo më pak se 4-herë në muaj komunikim me video i të gjithë të burgosurve me familjarët dhe të afërmit e tyre. Të miturve ju lejohej të paktën deri në 4 komunikime në muaj që sipas Institucionit të Avokatit të Popullit është i pamjaftueshëm dhe duhet të jetë më shumë se 4- herë në muaj pasi dhe qasja ndaj kësaj kategorie duhet të jetë e ndryshme.

## **Masat mbrojtëse**

Në Institutin e të Miturve Kavajë shërbimet psikosociale kanë qasjen e shërbimit multidisiplinor, i cili për çdo të mitur fillon menjëherë, pas pranimit në mjediset e burgimit ose të paraburgimit. Nga vlerësimi i dosjeve psiko-sociale, çdo i mitur është intervistuar brenda 24 orëve, nga momenti i pranimit në mjediset e Institutit të të Miturve Kavajë.

Për çdo të mitur është përgatitur një raport psikologjik dhe social, në të cilin janë identifikuar dhe përshkruar faktorët, që shërbejnë si element kyç për llojin dhe nivelin e kujdesit dhe, programit që nevojitet për trajtimin e të miturit. Informacioni i marrë nga intervista dhe raporti janë elementë të rëndësishëm për vendosjen në mënyrë sa më të përshtatshme të të miturit brenda mjedisëve dhe, përcaktojnë nivelin e kujdesit dhe programit që duhet ndjekur për çdo të mitur. I gjithë dokumentacioni dhe veprimet e kryera, janë të administruara në dosjet individuale të të miturve. Për çdo të mitur në Institutin e të Miturve Kavajë është përgatitur një plan individual i trajtimit, duke specifikuar objektivat, periudhën kohore, mjetet, fazat dhe hapat konkretë, që duhet të ndiqen për realizimin e këtyre objektivave. Nga

---

<sup>3</sup> Urdhri nr.1419/1, datë 10.2.2021, i drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “Për limitet e harxhimit të karburanteve të miratuara nga DPB për automjete transporti, gjenerator, kaldaja në të gjitha IEVP-të për vitin 2021”.

këqyrja e dokumentacionit përkatës, konstatojmë se shërbimet e kujdesit psikosocial janë në përputhje me përcaktimet e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur<sup>4</sup>.

Regjistri i kërkesë/ankesave administrohej nga stafi i edukimit, të miturit në këtë institut, plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf ose jo. Ky i fundit i dërgonte në protokollin e institucionit. Pas protokollimit ia kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të miturit, sipas legjislacionit në fuqi. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se ato konsistonin më shumë në kërkesa si: Takim i zgjatur me familjarët, të shohin TV ditëve të shtunë dhe të djelë, takim me drejtuesin e institucionit etj.

Telefonat e vendosur në ambientet e regjimit funksiononin dhe të paraburgosurit e intervistuar online, pohuan se mund të flisnin me të afërmit e tyre sa herë të dëshironin nëpërmjet telefonave të vendosur nga institucioni me shpenzimet e institutit. Takimet me familjarët sipas urdhrit nr.372, datë 11.6.2021 Ministria e Drejtësisë, bëri të mundur vizitat e të miturve të privuar nga liria në Institutin e të Miturve Kavajë me familjarët, 4 herë në muaj, duke respektuar protokollet e Covid-19.

Ambientet e institucionit monitoroheshin me kamera për 24 orë. Sistemi i monitorimit me kamera ka gjithsej 46 kamera të jashtme dhe 25 të brendshme. Njëra nga DVR, ajo e cila ka 16 kamera, mban 21 ditë pamje filmike të regjistruara, kurse DVR-ja tjetër ku janë të instaluar 30 kamera, mban regjistrimin 12 ditë.

Theksojmë se mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve në një I.E.V.P, përveç atyre mjediseve ku çënohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, si një proces thelbësor për tre arsye:

**Së pari**, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

**Së dyti**, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgjeve dhe paraburgime, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore, apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

**Së treti**, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

## **Kushtet materiale**

Gjatë verifikimit të kryer nga grupi monitorues, si dhe nga intervista e realizuar me përgjegjës të shërbimit ligjor dhe me përgjegjës të çështjeve sociale, hapësirat e qëndrimit dhe të fjetjes ishin të mjaftueshme. Në këtë institucion, mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes së të miturve ishin të organizuara dhe të ndara në katër sektorë. Në përgjithësi, kushtet fizike të

---

<sup>4</sup> Neni 115, i ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”

mjediseve të fjetjes, ngrënies, tualeteve, dusheve, oborreve dhe hapësirave kreative, ku qëndronin dhe edukoheshin të miturit, ishin të mjaftueshme. Institucioni ishte i ndarë në 4 sektorë secili nga sektorët ishte me 5 dhoma banimi me kapacitet për 2 banorë, çdo dhomë banimi ishte e pajisur me tualet brenda saj.

Problematikat e vërejtura konsistonin në prezencën e lagështirës në mjediset e fjetjes, pothuajse në të gjitha dhomat, në korridoret e institucionit, në klasat ku zhvillohej mësim, si dhe në palestër. Drejtuesi i institucionit shpjegoi, se kjo lagështirë vinte nga tarraca, pasi ajo nuk ishte e izoluar.

Problematikë tjetër ishte dhe mungesa e ngrohjes, pasi kaldaja vihej në punë vetëm katër muaj, për katër orë në ditë, nëse temperaturat minimale të mjedisit binin nën +5 gradë celsius, kjo sipas urdhrat të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Në këtë institucion kishte 4 ambiente ajrimi të cilat ishin të pambuluara me tenda duke marrë parasysh kushtet klimaterike dhe ditët me shi që e pamundëson për të miturit të kryejnë orarin e ajrimit. Në regjimin e brendshëm ishte edhe fusha e futbollit, e cila ishte rikonstruktuar në muajin nëntor 2019, në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Futbollit.

Mjedisi i qëndrimit të përbashkët ishte i lyster dhe i pastër, në të ndodhej e vetëm një televizor ku të miturit kalonin shumicën e kohës. Dyshekët dhe shtretërit ishin në kushte të mira, niveli i higjienës ishte i kënaqshëm në të gjitha mjediset e vëzhguara.

Nga vëzhgimi i bërë në kuzhinën e këtij institucioni u vërejt, se kampionet i ushqimit të konservuar, **nuk** mbaheshin konform rregullave. Kontrolli mjekësor që kryej nga të miturve, evidentohet në një regjistër të veçantë, si dhe konstatoam përgjatë inspektimit se librezat shëndetësore të punonjësve të kuzhinës ishin me afat të skaduar dhe të pa nënshkruara.

Të miturit ngritën disa shqetësime lidhur me cilësinë e ushqimit, që ashtu siç na u konfirmua nga të gjithë të miturit linte për të dëshiruar. Ushqimi sipas të miturve ishte i pamjaftueshëm, darka sipas tyre ishte gjithnjë vetëm fasule, të miturit u shprehën se shpesh here janë ankuar tek drejtuesi i institucionit por nuk kanë parë asnjë përpjekje për ndryshim të gjendjes. Edhe më herët Avokati i Popullit ka evidentuar këtë problem që veçanërisht për të miturit duhet zgjidhet sa më parë edhe për shkak të fazës së zhvillimit në të cilën ata gjenden.

Uji i rrjedhshëm sigurohej 24 orë nga pusi, institucioni ishte pajisur me një filtrues uji, gjë që e bënte atë të pastër dhe të pijshëm, kjo e vërtetuar edhe nga analizat për kontrollin e cilësisë së ujit.

Në këtë institucion nuk funksiononte njësi tregtare, sepse subjektet private nuk paraqisnin interes për shkak të numrin të vogël të personave që trajtohen në të.

## **Regjimi dhe aktivitetet**

Institucioni i të Miturve Kavajë siguron mjediset dhe mjetet e përshtatshme dhe të nevojshme, që të miturit të kryejnë arsimimin shkollor dhe profesional, veprimtaritë çlodhëse, kulturore dhe çdo veprimtari tjetër të përbashkët ose individuale që kërkojnë ata.

Veç kësaj, në institucion kishte një bibliotekë dhe botime të ndryshme. Në këto mjedise të përshtatshme (e ashtuquajtura klasa), zhvillohet procesi mësimor për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë për 13 të mitur dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm, për 13 të mitur. Mësuesit vinin nga shkolla 9-vjeçare “Rilindja” dhe shkolla e mesme e përgjithshme “11 Shkurti” të qytetit të Kavajës, sipas marrëveshjes, ndërmjet ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Drejtësisë. Provimet e lirimimit nxënësit i jepnin në shkollë publike në qytetin e Kavajës. Ndërsa, gjatë inspektimit konstatuam, se kurset e formimit profesional nuk zhvilloheshin, për shkak të masave mbrojtëse për parandalimin e covid-19.

Në këtë institucion zhvilloheshin 3 kurse profesionale, punë me dru, saldim dhe hidraulik. Pjesëmarrës në ndjekjen e kurseve janë: Kursin e punës me dru e frekuentonin 8 të mitur, kursin e saldaturës e frekuentonin 7 të mitur, si dhe kursin e hidraulikës e frekuentonin 8 të mitur. Avokati i Popullit mendon se përfshirja e të miturve në këto aktivitete është e domosdoshme dhe duhet të merren masat për rifillimin e këtyre klasave.

Ajrimi i të miturve të paraburgosur dhe të dënuar bëhej konform rregullave në katër ambientet e ajrimit të institucionit. Ata nuk paraqitën ankesa lidhur me oraret e ajrimit, të cilat ishin konform standardeve dhe rregullores së institucionit.

Stafi i kujdesit social ishte i plotësuar në përbërje të tij kishte punonjës socialë dhe një psikolog. Punonjësit e këtij sektori kryenin aktivitetet sipas programit të miratuar më parë me një plan mujor.

Për sa i përket aktiviteteve rekreative në këtë institucion, nga ana e ekspertëve të Mekanizmit Kombëtar u konstatua se ato ishin të larmishme nga të cilat mund të përfitonin të dënuarit/paraburgosurit, si ndjekja e TV në dhomat e banimit ose në holle, lojërat e tavolinës, ushtrime në palestër, luanin pingpong, futboll, etj. Gjithashtu ka edhe një ambient për zhvillimin e aftësive në pikturë, për tu përdorur nga ata që kanë prirje në këtë fushë.

Në këtë institucion zhvilloheshin aktivitete dhe rite fetare. Drejtuesit e institucionit bashkëpunonin me organizata dhe shoqata të ndryshme, të cilat vinin për predikim dhe zhvillonin aktivitete të ndryshme fetare.

## **Shërbimet shëndetësore**

Nga intervistat me të burgosurit gjatë sesionit monitorues në këtë institucion nuk u konstatuan ankesa sa i përket shërbimit shëndetësor.

Organika e stafit të këtij sektori përbëhej nga 1 mjek, 1 stomatolog, 4 ndihmësmjekë dhe 1 ndihmësmjek/farmacist. Gjatë komunikimit na u konfirmua se në institucion mjeku punonte me kohë të pjesshme.

Dhoma e vizitave mjekësore ishte e pajisur me orenditë e domosdoshme dhe ishte me kushte fizike të mira.

Dhoma e stomatologut ishte plotësuar me poltron dhe autoklavë, stomatologu kryente disa shërbime si vizita, mjekime dhe mbushje.



Farmacia ishte e rregullt dhe furnizimi me medikamente bëhej nga DPB dhe Drejtoria e ISKSH sipas marrëveshjes tre paleshe të lidhur ndërmjet ISKSH-së, IEVP-ve dhe Depos Farmaceutike, si dhe nga fondi i veçantë për ilaçet, që nuk vinin nga dy burimet e para.

Dokumentacioni i stafit mjekësor e në veçanti të dokumentacionit të mjekut nga këqyrja e tyre rezultoi se regjistrat përkatës mbaheshin dhe plotësoheshin konform rregullave. Gjithashtu edhe kartelat mjekësore ishin plotësuar dhe mbaheshin të mbyllura në dollap me dry.

Nga këqyrja e regjistrave të vizitave mjekësore grupi i inspektimit konstatoi se në të shumtën e rasteve diagnozat për të miturit ishin bronkit, laringit, ftohje dhe sipas mjekut faktor kryesor i këtyre simptomave ishte lagështia e theksuar në institucion<sup>5</sup>.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ku parashikohet midis të tjerash se: “2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*.

## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për krijimin e mjediseve infrastrukturore të përshtatshme e në përputhje me nevojat e të miturve, me qëllim garantimin e ndërhyrjeve të domosdoshme për riparimin dhe eliminimin e lagështirës në ambientet e Institutit të Miturve Kavajë, situatë e cila ndikon seriozisht në shëndetin e të miturve.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërgjegjësimin e Drejtuesit të Institutit të Miturve Kavajë për një qasje më proaktive në mbrojtjen dhe kujdesin ndaj të miturve, si dhe rritjen e frymës së bashkëpunimit me institucionet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe atyre të të miturve në veçanti.

---

<sup>5</sup> Neni 75 Kushtet e të miturit në mjediset e paraburgimit, Ligj, Nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur. Gjatë kohës që i mituri mbahet në paraburgim, sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin, i ofrohet ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për identifikim dhe fillimin e ecurisë disiplinore, për ata punonjës të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë ushtruar dhunë psikologjike dhe komunikim jo etik me të miturit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e sasisë/kuotës të ushqimit për të miturit dhe larmishmërinë e tij.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me një frigorifer, i cili është i nevojshëm në rruajtjen e ushqimeve të sjella nga familjarët për të miturit.
6. Marrjen e masave e ndryshimit të rregulloreve për të adresuar nevojat e të miturve në një qasje tjetër të ndryshme nga të burgosurit e tjerë.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e vakancës së mjekut me kohë të plotë në Institucionin e të Miturve Kavajë, rekomandimi përsëritur vazhdimisht.
8. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për sigurimin e ngrohjes së vazhdueshme në të gjitha mjediset e Institutit të të Miturve Kavajë.
9. Marrjen e masave për pajisjen e ambienteve të ajrimit me tenda, të cilat ju përshtaten kushteve klimatike dhe mundësojnë ajrimin e të miturve në ditë me shi.
10. Marrjen e masave nga ana e institucionit për mbajtjen e kampioneve të ushqimit të konservuar konform rregullave.
11. Marrjen e masave për pajisjen e institucionit për shtimin e një kompjuter tjetër për të mundësuar komunikim pa pengesa të të miturve me familjarët, si dhe gjetjen e mundësisë për të siguruar dhe një televizor tjetër.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERE**

**ERMONELA XHAFI**